

# Rregullimi i Procedurës dhe të Dhënat Disiplinore në Komunën e Gjilanit 2022-2023

## Hyrje

Ndërtimi i një administrate lokale transparente dhe llogaridhënese dhe me integritet është njëri nga synimet kryesore të Republikës së Kosovës. Megjithatë, në veçanti integriteti në shërbimin publik vazhdon të mbetet sfidë. Në nivel komunal evidentohet nevoja për të promovuar hartimin dhe miratimin e planeve të integritetit në shërbimin publik si mjet për parandalimin e korrupsionit dhe sigurimin e disiplinës.<sup>1</sup>

Për ta arritur këtë qëllim përpos llogaridhënies para publikut, institucionet e Kosovës kanë ndërtuar mekanizma konkret të cilët kërkojnë llogari nga nëpunësit në procedurat administrative duke mos përjashtuar edhe procedurën penale në rastet kur shkeljet sanksionohen me Kodin Penal.

Mekanizma të llogaridhënies për zyrtarët publikë në Republikën e Kosovës janë vlerësimi i performancës dhe në veçanti procedurat disiplinore.

Për këtë qëllim, komunat kanë hartuar kodet e etikës ndërsa Qeveria e Kosovës ka miratuar rregulloren përkatëse për disiplinë.

BIRN në hulumtime paraprake kishte konstatuar se një numër i vogël i zyrtarëve të nivelit lokal përfshihen në procedura disiplinore për shkeljet e kryera gjatë punës.

Me qëllim të dokumentimit të kuptimit të arsyeve pse në vend ka numër të vogël të procedurave disiplinore, BIRN ka realizuar pesë hulumtime në komuna të ndryshme të vendit për të matur nivelin e edukimit për disiplinën dhe nivelin e zbatimit të procedurave dhe kodit të etikës në komunat përkatëse.

Në Komunën e Gjilanit BIRN ka gjetur se:

- Komuna e Gjilanit e ka hartuar Kodin e Etikës në të cilin parasheh rregullimin e disiplinës për të emëruarit politikë;
- Komuna nuk parasheh kritere për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit për të emëruarit politikë si dhe procedurë të qartë disiplinore;
- Komuna nuk ka ndërmarrë asnjë fushatë/aktivitet për të informuar qytetarët e saj për të drejtën e tyre për të iniciuar ankesë ndaj zyrtarit komunal kur ka pretendime për shkelje disiplinore dhe nuk kanë ndërmarrë asnjë promovim lidhur me përmbajtjen e Kodit të Etikës;

---

<sup>1</sup> Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2023, i qasshëm në linkun - [https://integrimievropian.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/12/Kosovo-2023-Report\\_SQ.pdf](https://integrimievropian.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/12/Kosovo-2023-Report_SQ.pdf)

- Komuna nuk ka mbajtur asnjë takim njoftues ose trajnim ndaj zyrtarëve të saj lidhur me Rregulloren Disiplinore dhe Kodin e Etikës së Komunës;
- Komuna nuk ka plan të detajuar të veprimit për zbatimin e tij;
- Të gjitha procedurat disiplinore janë hapur sipas detyrës zyrtare nga mbikëqyrësit direkt kurse nuk ka procedura të cilat janë iniciuar nga qytetarët apo organizatat e shoqërisë civile, ose nga zyrtarët komunalë;
- Komuna nuk ka të përcaktuar rregulla specifike për kompensimin e anëtarëve të komisioneve disiplinore brenda komunës;
- Anëtarët e Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit nuk i janë nënshtruar asnjë trajnimi para ose pas përzgjedhjes së tyre në Komision Disiplinor;
- BIRN ka identifikuar mungesë të një mekanizmi mbikëqyrës ndaj cilësisë së punës së Komisionit Disiplinor – në veçanti politikën ndëshkimore disiplinore të komisioneve disiplinore;
- Komuna e Gjilanit ka propozuar ndryshimin e Kodit të Etikës në fillim të vitit 2023, por për shkak të problemeve me Asambleenë nuk kanë arritur të fillojnë punën në adresim të çështjeve nga Kodi.

## Metodologjia

Ky raport paraqet të dhëna të grumbulluar në mes muajve shkurt dhe mars, duke përdorur tri forma të grumbullimit të të dhënave.

BIRN në metodologji ka përcaktuar qëllimet e hulumtimit duke i grupuar ato në tri shtylla:

- Niveli i Edukimit mbi Etikën dhe Disiplinën në komunë
- Analizimin e bazës ligjore të rregullimit të etikës dhe disiplinës
- Zbatimin në praktikë të kodeve të etikës dhe rregullave disiplinore

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë grumbulluar të shtrira në tri faza hulumtuese:

Në fazën e parë, BIRN ka realizuar një takim informues me zyrtarë të Komunës së Gjilanit dhe gjatë takimit janë marrë të dhëna paraprake për përgatitjen e fazës së dytë. Në fazën e parë BIRN po ashtu ka analizuar bazën ligjore të rregullimit të etikës dhe disiplinës në komunë, në raport me kërkesat që përcaktohen në standardet europiane të qeverisjes së mirë lokale.

Të dhënat nga faza e parë janë përdorur për të zhvilluar gjetjet e këtij raporti por edhe për të hartuar një pyetësor me 17 pyetje hulumtuese për zyrtarët komunalë të cilët janë përfshirë në studim.

Faza e dytë ka korresponduar me një matje në terren për të testuar njohuritë e zyrtarëve komunalë mbi kodin e etikës dhe procedurën disiplinore.

10 zyrtarë komunalë të përzgjedhur nga komuna i janë nënshtruar një procesi të testimit me 17 pyetje të përgatitura nga BIRN, e të cilat përmbajnë informacione për kodin e etikës dhe kodin e procedurës disiplinore.

Testimi është realizuar në prani të hulumtuesve të BIRN dhe zyrtarëve të komunës.

Zyrtarët e përfshirë në këtë studim ishin nga drejtoritë e Prokurimit, Financave, Administratës, Arsimit, Shëndetësisë. Identiteti i tyre është mbajtur i fshehur për qëllime të mbrojtjes së privatësisë.

Në fazën e tretë të hulumtimit, BIRN ka pranuar nga komuna përgjigjet në 12 pyetje hulumtuese në të cilat janë mbledhur të dhëna për:

- Numrin e ankesave disiplinore;
- Numrin e ankesave ex-officio disiplinore;
- Numrin e vërejtjeve nga menaxherët e linjës;
- Numrin e vërejtjeve dhe sanksioneve disiplinore nga komisionet përkatëse;
- Numrin e ankesave të hedhura poshtë nga institucionet, si Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil;
- Përdorimin e teknologjisë informative për të kontrolluar disiplinën (sistemi i burimeve njerëzore SIMBN). Sa përdoret ky sistem? A kanë njohuri për përdorim të këtij sistemi?;

Për këtë fushë dhe ka realizuar një intervistë të thellë me Udhëheqësin e Zyrës së Burimeve Njerëzore e cila korrespondon me mbi 30 pyetje hulumtuese. Të dhënat nga statistikave dhe intervista e thellë do të paraqiten në vazhdimësi gjatë këtij raporti.

## **Gjetjet kryesore**

### ***Kodi i Etikës parasheh procedurë disiplinore ndaj të emëruarve politikë***

Komuna e Gjilanit ka të themeluar komisionin disiplinor për Nëpunësit Civilë. Ky komision përbëhet nga tre anëtarë dhe në përbërje kanë së paku nga një jurist siç e parasheh edhe Ligji për Zyrtarët Publikë 08/L-197<sup>2</sup>. Po ashtu, Komuna e Gjilanit ka në zbatim Kodin e Etikës të cilin e ka miratuar në korrik të vitit 2020.

Në bazë të nenit 2 të këtij Kodi, në të cilin parashihet fushëveprimi i Kodit, aty theksohet se dispozitat e Kodit zbatohen për të gjithë zyrtarët e komunës gjatë ushtrimit të funksioneve, detyrave ose kompetencave publike.<sup>3</sup>

Të zgjedhurit dhe të emëruarit politikë nuk nënshkruajnë deklaratën e pranimit të Kodit të Etikës sikurse ndodh me shërbyesit civilë.

Kodi i Komunës së Gjilanit ka paraparë që edhe zyrtarët politikë komunalë t'i nënshtrohen përcaktimeve të këtij Kodi, si dhe është përcaktuar një procedurë specifike e rregulluar dhe disiplinore për ta.

*Neni 33 - “Zbatimi i kodit dhe masave disiplinore për të zgjedhurit dhe të emëruarit politikë” “Të zgjedhurit dhe të emëruarit politikë do t'i nënshtrohen procedurës disiplinore të vendosur nga ky Kod në rast të shkeljes së ndonjë prej dispozitave të Kodit.”*

<sup>2</sup> Ligji për Zyrtarët Publikë i qasshëm në linkun - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=81430>

<sup>3</sup> Kodi i Etikës së Komunës së Gjilanit, i qasshëm në linkun - <https://kk.rks-gov.net/gjilan/?s=kodi+i-etikes&paged=2>

## ***Komuna e Gjilanit në Kodin e saj ka paraparë një komision të veçantë e masa disiplinore për të emëruarit politikë***

Rregullorja për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë 11/2020 dhe Rregullorja për Disiplinën e Nëpunësve Civilë 01/2024 që ka shfuqizuar rregulloren paraprake, e që derivon nga Ligji për Zyrtarët Publikë 08/L-197, përjashton të zgjedhurit, të emëruarit politikë dhe zyrtarët e kabinetit.

Megjithatë, Komuna e Gjilanit ka paraparë një Komision të veçantë të cilin e krijon Kuvendi Komunal, i cili monitoron zbatimin e Kodit e i cili në përbërjen e tij ka pesë anëtarë, dy prej të cilëve janë nga anëtarët e kuvendit të komunës, një nga ekzekutivi dhe dy nga qytetarët me integritet dhe të njohur publikisht të komunës<sup>4</sup>.

Megjithatë, në Kodin në fjalë nuk është i paraparë asnjë kriter lidhur me përzgjedhjen e anëtarëve të kuvendit komunal, i cili do të mbikëqyrë dhe shqiptojë masa disiplinore ndaj të emëruarve politikë.

Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore për Komunën e Gjilanit, Besim Azizi, ka njoftuar se për mbikëqyrjen e disiplinës për të emëruarit politikë nuk është kompetent Komisioni Disiplinor, por një komision i veçantë i formuar nga Kuvendi Komunal.

*“Të emëruarit politikë nuk e kanë statusin e nëpunësve civilë, por ata janë të zgjedhurit e popullit, edhe komision mund të formojë vetëm Kuvendi Komunal për ta, ata (të emëruarit politikë) mund t'i përgjigjen atij. Komisioni Disiplinor nuk ka të bëjë asgjë me ta.”<sup>5</sup>*

Komuna e Gjilanit në Kodin e saj ka paraparë masat disiplinore të cilat mund të shqiptohen nga Komisioni i Kuvendit Komunal ndaj të emëruarve politikë të cilët kryejnë shkelje nga Kodi i Etikës.

Aty parashihet edhe qëllimi i masës, në të cilën thuhet se *“dënimi në mënyrë publike”* sjellja e papranueshme dhe ndikimi moral në sjelljen e ardhshme të përfaqësuesit të zgjedhur.

Masat të cilat mund të shqiptohen ndaj të emëruarve politikë në bazë të këtij Kodi, përveç ndalimit të pagës deri në 15% tre muaj, është edhe vërejtja publike e cila shqiptohet në mbledhje të kuvendit - publikimi i vërejtjes në ueb-faqen zyrtare të komunës.

*Neni 33 par. 5 “Masat për shkelje të Kodit të Etikës janë: Vërejtja publike - e cila shqiptohet në mbledhje të kuvendit dhe publikohet në ueb faqen zyrtare të komunës; Dënimi me ndalje deri në 15% të pagës për tre muaj”.*<sup>6</sup>

Në anën tjetër, për nëpunësit civilë Rregullorja tashmë e shfuqizuar 11/2020 dhe ajo aktuale 01/2024 për disiplinën e nëpunësve civilë përcaktojnë që seancat e Komisionit Disiplinor janë të mbyllura dhe mbahen në prani të anëtarëve të Komisionit si dhe parasheh numër më të gjerë të masave disiplinore për shkelje disiplinore.

Më tutje, Kodi i Etikës nuk ka paraparë se për cilat shkelje mund të shqiptohen masat në fjalë.

<sup>4</sup> Kodi i Etikës së Komunës së Gjilanit, i qasshëm në linkun - <https://kk.rks-gov.net/gjilan/?s=kodi+i+etikes&paged=2>

<sup>5</sup> Intervista e realizuar nga BIRN me z. Besim Azizi, Udhëheqës i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, datë 20 mars 2024

<sup>6</sup> Kodi i Etikës së Komunës së Gjilanit, i qasshëm në linkun - <https://kk.rks-gov.net/gjilan/?s=kodi+i+etikes&paged=2>

*“Të zgjedhurit dhe të emëruarit politikë do t’i nënshtrohen procedurës disiplinore të vendosur nga ky Kod në rast të shkeljes së ndonjë prej dispozitave të Kodit. Qëllimi i masës është që të dënohet publikisht sjellja e papranueshme në kundërshtim me këtë Kod dhe të ketë një ndikim moral në sjelljen e ardhshme të përfaqësuesit të zgjedhur”.<sup>7</sup>*

Ndonëse Kodi parasheh që të emëruarit politikë do t’i nënshtrohen procedurës disiplinore të vendosur nga i njëjti Kod, nuk është e qartë se për cilën procedurë është fjala.

Në nenin 32 të Kodit parashihet që procedura disiplinore për zyrtarët publikë zhvillohet sipas Ligjit për zyrtarët publikë, por në kuptim të kësaj, procedura e njëjtë është e pazbatueshme ndaj të emëruarve politikë, meqë ligji në fjalë i përjashton të emëruarit politikë nga zbatueshmëria e tij.

Tutje, Kodi nuk i parasheh qartë procedurat ndëshkimore e në të njëjtën kohë nuk është i qartë edhe roli i zyrtarit për sinjalizim në zbatimin e Kodit.

Njësia e Burimeve Njerëzore ka njoftuar se asnjë rast nuk është iniciuar për të emëruarit politikë në Komunën e Gjilanit.

### ***Mungesa e aktiviteteve njoftuese rreth Kodit të Etikës për qytetarët***

Komuna e Gjilanit përveç se e ka të publikuar Kodin e Etikës në ueb-faqen e Komunës, nuk ka ndërmarrë ndonjë aktivitet tjetër për të njoftuar qytetarët e Gjilanit lidhur me Kodin e Etikës si dokument, si dhe me të drejtën e tyre për të iniciuar kërkesë për inicim të procedurës ndaj zyrtarëve të komunës, procedurat që duhet ndjekur, afatet e parashkrimit të shkeljeve dhe çështjet tjera që ndërlidhen me procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve komunalë.

Viti	Numri i ankesave të paraqitura nga qytetarët ndaj zyrtarëve të Komunës
2022	0
2023	0

Të dhënat e paraqitura në tabelë më lartë pasqyrojnë sesi qytetarët në Komunën e Gjilanit nuk kanë paraqitur asnjë rast të vetëm në dy vitet e fundit për inicim të procedurës disiplinore ndaj zyrtarëve komunalë.

Rregullorja aktuale për Disiplinën e Nëpunësve parasheh mundësinë e inicimit të kërkesës për procedurë disiplinore edhe nga ana e qytetarit, kur i njëjti ka dyshim të bazuar për shkelje të detyrave dhe përgjegjësive të punës nga nëpunësi civil në komunë.

### ***Mungesa e trajnimeve për zyrtarët e Komunës lidhur me Kodin e Etikës dhe Rregullores për Disiplinë***

Numri i nëpunësve civilë dhe të emëruarve politikë në Komunën e Gjilanit është 294.

<sup>7</sup> Kodi i Etikës së Komunës së Gjilanit, i qasshëm në linkun - <https://kk.rks-gov.net/gjilan/?s=kodi+i-etikes&paged=2>

<sup>8</sup> Intervista e realizuar nga BIRN me z. Besim Azizi, Udhëheqës i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, datë 20 mars 2024

Numri i nëpunësve civilë në Komunën e Gjilanit	Numri i stafit politik në Komunën e Gjilanit
283	11

Kodi i Etikës është njëri nga dokumentet me të cilin njoftohen të gjithë zyrtarët e Komunës të cilët po ashtu nënshkruajnë edhe një deklaratë zotimi. Komuna e Gjilanit nuk ka ndërmarrë trajnime për zyrtarët e saj, për t'i njoftuar zyrtarët komunalë lidhur me rregullimin ligjor dhe nënligjor lidhur me disiplinën.

“Nuk kemi mbajtur trajnime për arsye se as rregullorja e re për procedurën disiplinore e as kodi nuk parasheh ndonjë dispozitë që ne duhet të mbajmë trajnime me ta si njësi e personelit” – tha z.Azizi.

Me aprovimin e Kodit të Etikës, të gjithë zyrtarëve komunalë të Komunës së Gjilanit u është përcjellë i njëjti më vërejtjen që ta lexojnë dhe t'i përmbahen, kurse aktivitete njoftuese nuk ka ndërmarrë, konfirmon z.Azizi.

Numri i ankesave të paraqitura nga zyrtarët komunalë ndaj zyrtarëve komunalë	Numri i ankesave të paraqitura nga mbikëqyrësi Direkt
0	7

Kjo tabelë pasqyron se në Komunën e Gjilanit përgjatë dy viteve të fundit 2022-2023, të gjitha procedurat disiplinore kanë qenë të iniciuara nga Mbikëqyrësit Direkt, kurse asnjë nuk ka qenë e iniciuar nga zyrtarët komunalë.

Komuna e Gjilanit në Kodin e saj të Etikës e ka paraparë detyrimin që zyrtarët komunalë të raportojnë tek komisioni ose mbikëqyrësi direkt kur janë në dijeni për ndonjë shkelje të Kodit<sup>9</sup>.

### ***Numri i ankesave të paraqitura në Komisionin Disiplinor për nëpunës civilë gjatë viteve 2022-2023***

Viti	Numri i Procedurave disiplinore të zhvilluara për nëpunës të shërbimit civil	Numri i ankesave të hedhura poshtë
2022	7	1
2023		

Kjo tabelë pasqyron numrin e ankesave të pranuar në Komisionin Disiplinor dhe nga 7 prej ankesave një është hedhur poshtë.

<sup>9</sup> Kodi i Etikës së Komunës së Gjilanit, neni 32, par.2, i qasshëm në linkun - <https://kk.rks-qov.net/gjilan/?s=kodi+i+etikes&paged=2>

### **Mënyra e zgjidhjes së rasteve**

<u>Nga Mbikëqyrësi Direkt</u>	Një vërejtje me shkrim
<u>Nga Komisioni Disiplinor</u>	3 raste ndalim 20% të pagës mujore për 2 muaj 1 rast ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë prej 2 vitesh

Kjo tabelë pasqyron të dhënat lidhur me llojin e masave të shqiptuara nga Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil në Komunën e Gjilanit.

Nga 5 masa disiplinore të shqiptuara nga ky Komision për tre nëpunës është shqiptuar masa e ndalimit 20% të pagës mujore për 2 muaj, kurse për një nëpunës është shqiptuar ndalimi i ngritjes në detyrë dhe ngritjes në shkallën e pagës për një periudhë prej 2 vitesh.

### **Ankesat e paraqitura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**

Numri i Ankesave të trajtuara	Numri i ankesave të hedhura poshtë	Numri i ankesave të aprovuara	Numri i ankesave të refuzuara
3	0	3	0

Sipas të dhënave të marra nga Komuna e Gjilanit, rezulton se 3 nëpunës civilë të kësaj komune i janë drejtuar me ankesë ndaj vendimeve të Komisionit Disiplinor përgjatë dy viteve të fundit Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Të gjitha ankesat e dorëzuara nga nëpunësit janë aprovuar nga Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në favor të nëpunësve.

### **Të dhënat nga pyetëtorët**

Me qëllim të pasqyrimin të njohjes së disa prej koncepteve bazike lidhur me Kodin e Etikës së Komunës dhe Rregullores për Disiplinë për Nëpunësit Civil, BIRN ka zhvilluar pyetëtorin për zyrtarët e Komunës së Gjilanit të cilët janë përzgjedhur në mënyrë rastësore ndërsa të dhënat që mund të identifikojnë pjesëmarrësit në pyetëtor nuk janë kërkuar.

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës në shërbimin civil të zyrtarëve pjesëmarrës në pyetëtor

2 zyrtarë	1 deri 5 vjet
1 zyrtar	5 deri 10 vjet
7 zyrtarë	Më shumë se 10 vjet

## Pyetjet dhe përgjigjet e zyrtarëve lidhur me Kodin e Etikës

Pyetja	Saktë	Pjesërisht Saktë	Pasaktë
1. Ndaj kujt zbatohet Kodi i Etikës së Komunës?	2	8	0
2. Sa është shuma e dhuratave që mund të pranojnë zyrtarët në punën e tyre?	9	0	1
3. Kujt duhet t'i raportoni për pranimin e dhuratave	9	0	1
4. Çka nënkupton situata e konfliktit të interesit?	5	0	5
5. Konfidencialiteti pas përfundimit të marrëdhënies së punës	8	0	2
6. Sa anëtarë ka komisioni disiplinor?	9	0	1
7. A lejohet pjesëmarrja në vendimmarrje për të disiplinuar, ngritur në detyrë, disiplinuar apo shkarkuar personin e afërm	9	0	1
8. Përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit të Etikës dhe njoftimit është Njësia e Burimeve Njerëzore?	10	0	0

Nga të dhënat e pyetësorëve të realizuar rezultojnë se zyrtarët kanë njohuri lidhur me konceptin e nepotizmit gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, pranimin e dhuratave e raportimit të tyre, mbikëqyrjen e zbatimit të kodit të etikës, si dhe përbërjen e komisionit disiplinor.

Kurse, 50% e zyrtarëve të intervistuar nuk kanë pasur njohuri lidhur me konceptin e konfliktit të interesit.

### **Trajnimet e zyrtarëve komunalë lidhur me Kodin e Etikës apo Rregulloren për Disiplinë**

2 trajnime	1 zyrtar
1 trajnim	3 zyrtarë
Asnjë deri më tani	6 zyrtarë

Kodi i Etikës së Komunës së Gjilanit parasheh që për trajnimin e zyrtarëve të saj, përgjegjëse është Njësia për Menaxhimin e Burimeve njerëzore.<sup>10</sup> Nga 10 zyrtarë të intervistuar me pyetësor, 6 nga ta kanë deklaruar se nuk është zhvilluar asnjë trajnim ndaj tyre lidhur me Kodin e Etikës apo Rregullores për Disiplinë, kurse një zyrtar ka deklaruar se janë zhvilluar dy trajnime ndaj tij, kurse 3 kanë deklaruar se është zhvilluar një trajnim ndaj tyre.

<sup>10</sup> Kodi i Etikës së Komunës së Gjilanit, neni 30, par.3, i qasshëm në linkun - <https://kk.rks-gov.net/gjilan/?s=kodi+i+etikes&paged=2>



## Pyetjet dhe përgjigjet e zyrtarëve komunalë lidhur me Rregullat dhe procedurën disiplinore

Pyetja	Saktë	Pjesërisht Saktë	Pasaktë
1. Kush është kompetent për shqiptimin e masave disiplinore?	0	9	1
2. Me rastin e shqiptimit të masës disiplinore merren parasysh edhe përpjekjet për zvogëlimin e dëmit?	8	0	2
3. Sa është afati për ankesë ndaj vendimit disiplinor?	7	0	3
4. Shkelja e përsëritur e rregullave të Kodit të Etikës konsiderohet si shkelje e lehtë?	8	0	2
5. Kush e shqipton masën “ndalimi i ngritjes në detyrë”?	9	0	1
6. Afati i parashkrimit të shkeljeve të lehta është 3 vjet kurse i shkeljeve të rënda 6 vjet?	5	0	5
7. Kush e bënë kualifikimin e shkeljeve në të rënda apo të lehta?	0	0	10
8. Kush e themelon Komisionin Disiplinor?	9	0	1
9. Kush është shkalla e dytë ndaj vendimeve të Komisionit Disiplinor?	8	0	2

Nga pjesa e pyetjeve nga Rregullorja për Disiplinë rezulton se për shumicën dërrmuese të pyetjeve zyrtarët kanë pasur njohuri bazike.

Nga 10 zyrtarë të intervistuar 9 zyrtarë kanë pasur njohuri se kush e themelon Komisionin Disiplinor, kurse asnjëri nga prej tyre nuk ka pasur njohuri se kush është autoriteti i cili e bën kualifikimin e shkeljeve të lehta dhe të rënda në procedurë disiplinore.

Zyrtarët kanë shfaqur njohuri relativisht të saktë lidhur me shqiptimin e masave disiplinore, kurse lidhur me parashkrimin e afatit për shkeljet vetëm 5 zyrtarë janë përgjigjur në mënyrë të saktë.

### ***Mungesa e trajnimeve për anëtarët e Komisionit dhe mungesa e kompensimit shtesë për anëtarët e komisionit disiplinor***

Anëtarët e komisioneve disiplinore të Komunës së Gjilanit nuk i janë nënshtruar asnjë trajnimi lidhur me zbatimin e Kodit të Etikës së Komunës, procedurave disiplinore të përcaktuara me rregulloret dhe Ligjin për Zyrtarët Publikë, para se të përzgjidheshin ose pasi janë përzgjedhur.

Po ashtu, zyrtarët që shërbejnë si anëtarë të komisioneve disiplinore nuk kompensohen për punën e tyre si anëtarë të komisioneve, konfirmon z.Besim Azizi.

## **Rekomandimet:**

- Komuna e Gjilanit të plotësojë Kodin e Etikës dhe të përcaktojë procedura efikase dhe të barabarta në trajtimin e rasteve disiplinore ndaj të zgjedhurve dhe të emëruarve politikë dhe stafit të tyre mbështetës;
- Komuna e Gjilanit të përcaktojë kritere të përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit për të emëruarit politikë;
- Komuna e Gjilanit të ndërtojë fushata vetëdijesuese me qëllim të njoftimit të qytetarëve të Komunës rreth Kodit të Etikës dhe procedurave disiplinore, të cilave mund t'iu nënshtrohen zyrtarët komunalë me qëllim të rritjes së numrit të ankesave të qytetarëve;
- Komuna e Gjilanit të fillojë programe trajnimi për zyrtarët komunalë lidhur me Kodin e Etikës dhe procedurat disiplinore të parapara me Rregulloren për Disiplinë;
- Komuna e Gjilanit të zhvillojë trajnime me zyrtarët komunalë me qëllim të përditësimit të njohurive lidhur me vendimmarrjen në situata të konfliktit të interesit dhe konfliktit të interesit në përgjithësi;
- Komuna e Gjilanit të fillojë programe për trajnimin e anëtarëve të komisioneve disiplinore;
- Komuna e Gjilanit të fuqizojë kapacitetet e zyrtarëve komunalë në drejtim të instrumenteve për parandalimin e korrupsionit;
- Komuna e Gjilanit të ndërtojë modalitete për mbikëqyrjen e cilësisë së punës, në veçanti politikën ndëshkimore disiplinore të komisioneve disiplinore;

*Kjo analizë është përgatitur nga BIRN-i përmes mbështetjes nga Aktiviteti i Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) për Integritetin e Komunave të Kosovës. Pikëpamjet e paraqitura në këtë artikull nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.*